

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 7989
E martë, 11 shkurt 2025
Çmimi 0.50

Kryetari i bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, shoqërohet në polici



FACE 4

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com




facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPOZITA PËRJASHTON KOALICIONIN ME LV-në, PRET DËSHTIMIN E KURTIT QË TA FORMOJË QEVERINË VETË

FACE 4-5



Liderët e partive opozitare të hënën kanë përjashtuar çdo mundësi bashkëpunimi për ndonjë koalicion me Lëvizjen Vetëvendosje e cila në zgjedhjet e 9 shkurtit ka dalë e para me

vota me rreth 41.10 për qind, ndërkaq tri partitë opozitare bashkë kanë më shumë vota, rreth 47.48 për qind. Kandidati i PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza, në një konferencë për

medie ka thënë se nuk do të hyjnë në koalicion me LV-në. Ai ka bërë me dije se do të punojnë për t'ua dhënë qytetarëve "qeverinë për të cilën kanë votuar shumica"

PËRKUJTOHEN MON BALAJ DHE ARBEN XHELADINI F.7



MISIONI I KIE-S: KOSOVA MBAJTI ZGJEDHJE PAQËSORE, POR PËRFAQËSIMI I GRAVE MBETET I ULËT F.6



OPINION

JO FASHIZËM NË DEMOKRACI: RRESHTIMI I KOSOVËS ME ALEATËT NDËRKOMBËTARË - NJË DOMOSDOSHMËRI PËR TA SHMANGUR IZOLIMIN DHE KONFLIKTIN E NGRIRË F.6

Shkruan: Prof. dr. Fejzulla BERISHA



AKTUALE



JEP DORËHEQJE PRESIDENTI I RUMANISË, KLAUS IOHANNIS F.2

ODA AMERIKANE SHPREH SHQETËSIMIN PËR SULMET VERBALE NDAJ MEDIEVE DHE INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË F.7

EKONOMI



RRITJA E ÇMIMEVE, QYTETARË TË SHUMTË BOJKOTOJNË SUPERMARKETET NË KOSOVË F.8

PËRMBYLLET PROJEKTI ME GIZ-IN "BASHKË PËR NJË AMBIENT MË TË PASTËR" F.8

RENOVA
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renovamt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Jep dorëheqje presidenti i Rumanisë, Klaus Iohannis

BUKURESHI, 10 SHKURT - Presidenti i Rumanisë, Klaus Iohannis, ka njoftuar se ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë. Ky njoftim erdhi teksa opozita rumune bëri një përpjekje për ta rrëzuar atë nga pozita, pasi ai qëndroi si president edhe pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese për t'i anuluar zgjedhjet presidenciale, raundin e parë

të cilave e fitoi kandidati i krahut të djathtë, prorusi Calin Georgescu. Klaus tha më 10 shkurt se ai do të largohet nga pozita e presidentit pas dy ditësh. Gjykata Kushtetuese i kishte kërkuar atij të qëndronte në pozitën e presidentit edhe pas mandatit të tij, që i përfundoi në mesin e dhjetorit, për shkak të anulimit të

zgjedhjeve. Gjykata Kushtetuese anuloi zgjedhjet dy ditë para se të mbahej raundi i dytë mes Georgescut dhe kandidatës proeuropiane, Elena Lasaconi. Gjykata citoi dokumente shtetërore që supozohet se tregonin që Georgescu, i cili garoi si kandidat i pavarur, kishte përfituar nga një

fushatë e padrejtë në rrjetet sociale që, me gjasë, ishte orkestruar nga Rusia. Moskë ka mohuar se ka ndërhyrë në zgjedhjet në Rumanë. Zgjedhjet e reja presidenciale planifikohen të mbahen më 4 maj dhe nëse asnjë nga kandidatët nuk merr shumicën, raundi i dytë do të mbahet më 18 maj.



Scholzi përsërit kundërshtinë për dërgimin e raketave Taurus në Ukrainë

BERLIN, 10 SHKURT - Kancelari gjerman Olaf Scholz sërish ka përjashtuar mundësinë që Ukrainës t'i dërgohen raketa me reze të gjatë veprimi, Taurus, duke kundërshtuar veprimet që do të "përdorshin armë shkatërruese" thellë brenda Rusisë. Ai i bëri këto komente që, me gjasë, janë kundërpërgjigje për kundërshtarin e tij politik konservator, i cili ka shprehur më shumë gatishmëri që armë të tilla t'i jepen Kievit. "Nuk mendoj se është e drejtë të dërgohen armë shkatërruese thellë brenda territorit rus", tha Scholz gjatë një debati televiziv më 9 shkurt para zgjedhjeve gjermane që do të mbahen brenda dy javës. "Ky është pikërisht ai lloj hapi që nuk duhet të ndërmerret nëse mbani

përgjegjësi për Gjermaninë", shtoi ai. Friedrich Merz, aleanca konservatore e të cilit CDU/CSU është duke udhëhequr në sondazhe kundrejt SPD-së të Scholzit, tha se ai gjithmonë "e kam bërë të qartë" qëndrimin sa i përket dërgimit të raketave Taurus në Ukrainë. "Gjithmonë e kam thënë, dërgimi i raketave lundruese duhet të vendoset në Bashkimin Evropian. Shtetet e Bashkuara kanë dërguar, Franca dhe Britania po ashtu dhe ne është dashur ta bëjmë", tha Merz. Merz kishte deklaruar për mediet gjermane në tetor se ai do ta miratonte dërgimin e raketave për në Kiev nën disa kushte të posaçme. Këto raketa kanë një reze veprimi prej rreth 500

kilometrash. Nëse Rusia sulmon Ukrainën, "mos u ndal, dhe hapi i parë është ky: Largo kufizimet për rrezet e veprimit të armëve. Dhe hapi i dytë është që ne t'i dërgojmë raketa Taurus", deklaroi ai. Kështu, tha Merz, presidenti rus, Vladimir Putin, "ka në duar çështjen se sa dëshiron ta përshkallëzojë situatën". Në korrik DW raportoi se Merz ishte në favor që Berlioni ta ndihmonte Kievin me avionë luftarakë në mënyrë që të mbrohej kundër agresionit rus. Edhe pse Scholz është shprehur më hezitues për t'i dërguar Kievit armatim të rëndë, Berlioni është i dyti, pas Uashingtonit, sa i përket ndihmës së ofruar për Ukrainën. Scholz ka insistuar se është



thelbësore të sigurohet "sovrانيتeti i Ukrainës dhe që shteti të mos detyrohet që të nënshtrohet". Sa i përket politikës së brendshme, Scholz po tenton të fitojë më shumë mbështetje për ta ndryshuar renditjen në sondazhe për zgjedhjet e 23 shkurtit, duke e

akuzuar Merzin se po tenton ta marrë mbështetjen e partisë të ekstremit të djathtë, Alternativa për Gjermaninë (AfD). Por, Merz ka thënë se aleanca e tij nuk do të bashkëpunojë apo qeverisë me AfD-në, partinë kundër emigrantëve.

Trumpi do të vendosë 25 % tarifa për importet e çelikut dhe aluminit



UASHINGTON, 10 SHKURT - Presidenti i SHBA-së, Donald Trump, tha të dielën se do të shpallë tarifa të reja 25 % për të gjitha importet e çelikut dhe aluminit në SHBA, një shtesë përtej taksave ekzistuese për metalet, në një tjetër përshkallëzim të politikës së tij tregtare. Trumpi, duke folur para gazetarëve në avionin

presidencial Air Force One, tha se do t'i shpallë tarifën reciproke të martën ose të mërkurën dhe se ato do të hyjnë në fuqi pothuajse menjëherë. Gjatë mandatit të tij të parë, presidenti Trump vendosi tarifa prej 25 % për çelikun dhe 10 % për aluminit, por më vonë i hoqi taksat për disa partnerë tregtarë, përfshirë Kanadanë, Meksikën

dhe Brazilin. Ish-presidenti Joe Biden më pas hoqi tarifën edhe për Britaninë, Japoninë dhe Bashkimin Evropian. Shfrytëzimi i kapaciteteve të çelikut në SHBA ka rënë në vitet e fundit. Zëdhënësjë e Shtëpisë së Bardhë Karoline Leavitt tha se tarifën e reja do të jenë një shtesë mbi detyrimet ekzistuese për çelikun

dhe aluminit. Trumpi njoftoi të premten se do të vendosë tarifa reciproke - duke rritur normat e tarifave të SHBA-së në përputhje me ato të partnerëve tregtarë - për shumë vende këtë javë. Ai nuk identifikoi vendet, por tha se tarifën do të vendosen "në mënyrë që të trajtoheni në mënyrë të barabartë me vendet e tjera".

Këshilltari për Sigurinë Kombëtare, Waltz, mbron planin e presidentit Trump për Gazën

UASHINGTON, 10 SHKURT - Këshilltari amerikan për Sigurinë Kombëtare, Mike Waltz, gjatë fundjavës iu përgjigj kritikëve të planit të presidentit Donald Trump për ta marrë kontrollin mbi Rripin e Gazës. Ndërkohë, siç njofton korrespondentja e Zërit të Amerikës, Veronika Balderas Iglesias, armëpushimi ndërmjet Izraelit dhe Hamasit po vazhdon të respektohet; gjatë fundjavës dyja të palët

shkëmbyen pengje izraelite që mbaheshin nga grupi militant palestinez me të burgosur palestinezë. Marrëveshja e armëpushimit ndërmjet Izraelit dhe Hamasit po vazhdon të zbatohet. Forcat izraelite u tërhoqën të dielën nga korridori që ndan Rripin e Gazës dhe familje të tëra palestineze filluan rrugëtimin për t'u kthyer në shtëpitë e tyre në pjesën veriore të Gazës. Por se çfarë pritet të ndodhë

me banorët e Gazës pas përfundimit të luftës, mbetet çështje e hapur. Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka qarkulluar idenë që popullsia e Gazës të rivendoset në shtete të tjera dhe Shtetet e Bashkuara ta marrin Gazën nën kontroll për ta rindërtuar. Këshilltari për Sigurinë Kombëtare i presidentit Trump, Mike Waltz, iu përgjigj atyre që kanë kritikuar planin

të dielën. "Nuk mund ta shndërrosh Gazën në Parisin e Mesdheut siç ishte Bejruti në vitet '70 për t'u siguruar këtyre banorëve një jetë më të mirë kur ke 1.8 milion njerëz të cilët jetojnë në skamje absolute dhe mbi grumbuj rrënojash. Të gjithë ata që nuk e pëlqejnë propozimin e tij, përshirë mediet, e jani te ne po patët një plan më të mirë", deklaroi Waltz në një intervistë për emisionin "Meet the Press" të



televizionit NBC. Plani i presidentit Trump ka gjetur mbështetje në Izrael, por bota arabe dhe udhëheqësit palestinezë e kundërshtojnë atë tërësisht.

BE-ja mirëpret mbarëvajtjen e zgjedhjeve në Kosovë

PRISHTINË, 10 SHKURT - Bashkimi Evropian ka përshëndetur faktin që zgjedhjet parlamentare në Kosovë u zhvilluan në një atmosferë të qetë, në të cilën qytetarët kanë pasur mundësi ta shprehin vullnetin e tyre. Kështu tha zëdhënësja e BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Anitta Hipper, kur u

përgjigj në pyetjet lidhur me reagimin e bllokut për zgjedhjet në Kosovë dhe pritjet pas mbajtjes së tyre. Hipper tha se në Kosovë është vendosur misioni vëzhgues i BE-së për zgjedhjet që është formuar me vendimin e shefes së diplomacisë, Kaja Kallas. Vendimi për dërgimin e këtij misioni për t'i vëzhguar

zgjedhjet në Kosovë nga Hipper u përmend si dëshmi se BE-ja i sheh raportet me Kosovën si shumë të rëndësishme. Përveç vëzhguesve nga BE-ja, zgjedhjet u monitoruan edhe nga vëzhguesit vendorë, që thanë se ato kaluan pa incidente serioze, por me disa parregullsi.




Kryetari i bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, shoqërohet në polici

TIRANË, 10 SHKURT - Kryetari i bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, është marrë nga zyra e tij dhe është dërguar në stacionin e policisë së kryeqytetit të hënën. As policia e as Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit (SPAK) ende nuk kanë njoftuar rreth kësaj çështjeje, që besohet se ka të bëjë me korrupsion. Sipas burimeve, Gjykata e Posaçme ka urdhëruar që Veliaj të dërgohet në paraburgim, ndërsa bashkëshortja e tij të mbahet në arrest shtëpiak. Ai u ndalua bazuar në një hetim të nisur vitin e kaluar në lidhje me dyshimet për veprën penale "korrupsion pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë", pas një referimi të dorëzuar në SPAK më 8 shkurt të 2024-s. Në fund të dhjetorit, Veliaj ishte thirrur në Gjykatën e Posaçme Kundër Korrupsionit. Ai u tha gazetarëve se ishte denoncuar në mënyrë anonime nga një person i quajtur Nesti Angoni. "Ky person nuk ekziston, e dimë çfarë emri dhe kulture linçuese përfaqëson ky stil. Është një kurth i sajuar. Jam sulmuar nga Nesti Angoni për

të na kthyer pas te praktika e letrave anonime", tha Veliaj asokohe. Ai pati theksuar më 26 dhjetor pasi u thirr në SPAK se "do të ishte shqetësuese nëse nuk do të paraqitej para Prokurorisë së Posaçme se nuk bënte pjesë tek ata politikanë që e sulmojnë SPAK-un kur i heton". I pyetur për këtë çështje, kryeministri Edi Rama pati deklaruar gjatë konferencës së fundvitit me gazetarët se ndaj Veliajt po bëhej gjyq publik, dhe se ai do të mbante qëndrim në kohën e duhur. Reagimi i parë pas shoqërimit të Veliajt të hënën erdhi nga Lulzim Basha, i cili më herët ka drejtuar bashkinë e Tiranës dhe Partinë Demokratike. Ai tha se "Veliaj me mbështetjen e kryeministrit Edi Rama e ktheu bashkinë e Tiranës në vatër korrupsioni". "Përshëndes vendosmërinë e SPAK-ut për t'u shkuar deri në fund aferave korruptive dhe i inkurajoj institucionet e drejtësisë të veprojnë pa asnjë hezitim kundër korrupsionit në nivelet e larta, që shkatërron mirëqenien e familjeve shqiptare", tha Basha.



Misioni i KiE-s: Kosova mbajti zgjedhje paqësore, por përfaqësimi i grave mbetet i ulët



PRISHTINË, 10 SHKURT - Misioni vëzhgues i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (PACE) i ka vlerësuar zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit në Kosovë gjithëpërfshirëse dhe paqësore, megjithëse tha se përfaqësimi i grave në zgjedhje vazhdon të jetë i ulët. Petra Bayr, shefe e delegacionit të PACE që i vëzhgoi zgjedhjet e

së dielës në Kosovë, tha të hënën në një konferencë për medie në Prishtinë se "i gjithë procesi i zgjedhjeve ishte shumë cilësor". "Votuesit e Kosovës kanë demonstruar zotimin e tyre për demokraci duke votuar në mënyrë paqësore dhe pa tensione gjatë 9 shkurtit 2025 për zgjedhjet parlamentare. Këto zgjedhje kanë shfaqur një relief politik

në të cilin janë përfaqësuar si komuniteti shumicë, ashtu dhe ai pakicë. Për më shumë, pjesëmarrja e serbëve të Kosovës që ka pasur një gamë më të gjerë të zgjedhjes politike ka mundësuar proces edhe më demokratik", tha Bayr. Në zgjedhjet e 9 shkurtit morën pjesë shumë parti nga komunitetet pakicë, nga to gjashtë parti nga pakica serbe,

përfshirë Listën Serbe, e cila i kishte bojkotuar institucionet e Kosovës nga viti 2022. Por, Bayr tha se përfaqësimi i grave në fushatë në këto zgjedhje nuk shënoi rritje. "Përfaqësimi i grave mbetet i ulët. Gjuha e urrejtjes online kundër grave ka pasur ndikim në pjesëmarrjen apo paraqitjen e tyre në këto zgjedhje", tha ajo.

Drejtuesi i fushatës së Trumpit merr drejtimin e fushatës së Sali Berishës

Tiranë, 10 shkurt - Chris La Civita, drejtuesi i fushatës së Donald Trumpit në ShBA, është paraqitur të hënën si drejtuesi i fushatës së Partisë Demokratike në

Shqipëri. Në lidhje me këtë lajm ka reaguar edhe këshilltari për çështjet ekonomike në PD, Dorjan Teliti. Ai shprehet se PD-ja me këtë zgjedhje të

jashtëzakonshme po shkon drejt fitores në zgjedhjet e 11 majit. "Lajm i madh për shqiptarët dhe Shqipërinë! Chris La Civita, strategu i fitores historike të Donald

Trumpit, do ta drejtojë fushatën e Partisë Demokratike për zgjedhjet e 11 majit! Një strateg fitues për një Shqipëri që fiton", ka shkruar Teliti në "Facebook".



Qëndrime të Muhamet Mavrajt për fushatën elektorale të zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit, për ditën e votimit dhe pas ditës së votimit

Publicisti Muhamet Mavraj në shkruar se Kosova e kaloi edhe një test qytetërues. “Mendoj se opozita ia doli, por duhet ta respektojë përparësinë e partisë së parë për të provuar formimin e qeverisë. Nëse dështon, mandati i jepet partisë së dytë”, ka shkruar Mavraj.

Muhamet Mavraj
6h · 🌐

Lini te thone se eshte 9 kur duket 6.

Fitues opozitare, jeni dinjitozet e vendit! Refuzojeni gjuhen e tyre, sidomos ne kete jave. Me cdo kusht! Çdo lloj ofendimi injorojeni, mos u beni muzike.

Nese dikush behet muzike e te marrit kur vallezon, ai do te duket valltar i mire deri dikund dhe jo i marre. Nese e lini te vallezoje pa muziken qe i duhet, ai do te duket sic eshte.

Interpretimi i humbjes se paster si fitore me gjuhe agresive ofenduese asnje gje nuk e nderron ne tabelen e rezultateve. Tregon vec dobesite e veta.

Shiheni pak edhe kontekstin kalendarik, shiheni kontekstin politik dhe gjyqesor (Haga), kontekstet penale pushtetare, zgjedhjet lokale te sivjetme, zgjedhjen e kryetarit te shtetit pas nje viti. (Per humeren socio-ekonomike nuk po diskutojme).

Lini te thone se eshte nente kur duket 6. Mos u ngutni, se vonoheni.

📷



Avokat Agron Kajtazi, Avni Krasniqi and 275 others · 18 comments · 18 shares

Muhamet Mavraj
Yesterday at 7:43 PM · 🌐

Kosova e kaloi edhe nje test qyteterues.

Gjysme ore pas votimeve, pikerisht tani jemi ne momentin per te deklaruar, ne parim, pranimin e procesit zgjedhor dhe cfaredo rezultati.


Gezim, mos u gezo!
Idhnm mos u idhno!

Votimi me inercion kerkon kohen e vet per te ndryshuar, ndersa opozita duhet te jete e bashkuar perballe realitetit.

Mendoj se opozita ia doli, por duhet ta respektojë përparësinë e partisë së pare per te provuar formimin e Qeverise. Nese deshton, mandati i jepet partisë se dyte.

Meqenese vitin tjeter vjen sfida e 80 votave per kryetar shteti, keto parti do te benin mire ta gjenin nje formule qe na kursen nga zgjedhjet e jashtezakonshme dhe humbjes se metejme te kohes se Kosoves qe po zvarritet per se paku nje dekadë e sidomos ne 6 vitet e fundit. Nuk dua ta zhvleresoj fjalen, por vitet e humbura jane aktualisht qellimi kryesor i fqinjit verior. Deri ketu ka korrur disa beteja fituese, prandaj jemi ne kurthin e konfliktit te ngrire.

Te mos harrojme: kiblen duhet ta kthejme kah Perendim!
Kosova, per zgjedhjet e qeta e te rregullta do te marre serish note te mire.



Avokat Agron Kajtazi, Avni Krasniqi and 303 others · 23 comments · 3 shares

Muhamet Mavraj
Yesterday at 10:04 AM · 🌐

Si gjithmonë, që nga viti 2000, votova sapo u hapen vendvotimet. (Rrugës u ndala pak te dada Madeleine Albright këtu në Prishtinë).

Bota po na vëzhgon, dhe ne dimë ta kalojmë testin e qytetarisë edhe nëse nuk na vëzhgon, por sot po na vëzhgon edhe historia.

Nuk votova budallenj as dele, sepse ata na krijojnë pastaj qeveri me shokët budallenj e shoqet dele, duke i vendosur madje edhe në krye të profesorëve, por votova intelektualë nga të gjitha gjeneratat e gjinitë, edhe emra të rinj që shpyr janë me bollëk, edhe një përfaqësimit mërgate. Për respekt të kundërshtarëve gjithnjë përfshij nga ato ca votat kundër Speciales, që nuk gjinden atje te zhurma asnjë për be, madje as shoku yne Rexhë që ndodhet vetë në Hagë. (Burja boshe bën zhurmë të madhe: ata zhurmuan por u larguan nga Kuvendi në momentin e votimit dhe nuk pranuan të regjistrohen në histori si votues me votë kundër).

Vetëm sot je i barabartë me të gjithë dhe vetëm sot “vota është më e fuqishme se plumbi”, dhe ta mbyllim pak gojën e ta hapim mendjen sot, SOT, sepse, siç ka thënë Abraham Linkolni, “me plumb mund ta vrasësh armikun tënd, ndërsa me votë mund të vrasësh të ardhmen e fëmijëve tu”!

Të dashur miq,
Këto parti dhe këta kandidatë nuk janë më të mirët, por më të mirë nuk po kemi. Nëse ju nuk votoni, do t’i nënshtroheni vullnetit të atyre që tashmë po votojnë!

Mos të harrojmë: Rezultatet të pranohen pa e zgjatur, menjëherë dhe me marifet! Ne jemi në themelet e civilizimit evropian, shumë të hershëm, më të parët.

Përhëndetjet të përzemërta për të gjithë Ju, miqte e mi, kudo që jeni, shëndet, qetësi dhe lumturil! Bëhet mirë!

📷

Muhamet Mavraj
February 8 at 3:49 PM · 🌐

Bota na vëzhgoi për një muaj në fushatën civile parazgjedhore dhe na vëzhgon edhe neser dhe deri ne certifikim të rezultateve. Duhet te jemi shume te matur!

Asnje parti shqiptare nuk e hapi as mbylli fushaten ne veri te Kosoves. Bojkoti serb nuk po shitet per “çlirim” dhe pika 7 e Ohrit nuk zbehet keshtu. As ura nuk u permend diçka. Por, as shperthimi ne Iber-Lepenc.

Zgjedhja neser eshte e thjeshte: te rrite ku jemi, -ne grup me dy shtetet tjera te sanksionuara nga Perendimi , Rusia e Bjellorusia, apo te kthehemi kah ishimi, kah kibra perendimore.

Vetem neser te gjithë jane te barabarte. Vlen njeje vota e dijetarit dhe ajo e budalles, e qytetarit te thjeshte dhe e pushtetarit. Ia pafshim hajrin rezultatit cfaredo qe te jete!

Në fillim të fushatës kam thënë në Frontal se BEDRI HAMZA ka qenë i mirë për kryeministër edhe më moti, por tani është IMPERATIV për fatin e atdheut ne krye te koalicionit te partive shtetformuese LDK, PDK, AAK-NISMA me tjeret dhe Lista per FAMILJEN. Keto treguan superioritet ne shtjellimet profesionale programore per jeten e renduar te mbare kombit.

Si bashkethemelues i Partisë Demokratike mendoj se nëse Hamza nuk udhëheq me Qeverinë bashkë me partitë shtetformuese, subjekti politik nuk duhet të përfshihet në Qeveri, as si parti drejtuese dhe as bashkëdrejtuese, ndonese mund ta ndihmoje ndryshimin teknikisht edhe pa u përfshire ne Qeveri. Ka paguar faturë të rëndë elektorale duke ua dhënë postin partive të tjera 2014-2019 dhe ka marrë mosmirënjohje e poshtërime jashtëzakonisht të rënda. Vijnë zgjedhjet tjera.

Te deshmojme si gjithmone qysh treguam ne shqiptaret se demokracia eshte specialiteti yne ne Evropen Juglindore: kulturë, qetësi, ndershmeri, rregullsi dhe respekt ndaj traditave më të mira civilizuese e demokratike. Njohja dhe pranimi në qetësi i rezultateve vulos traditën tonë të mirë!

Te dashur miq, ju uroj suksese ne votimet tuaja per kendo qe ua thote mendja e zemra dhe ju uroj lumturine e botes per gjithë jeten tuaj, kudo qe te jeni!

📷



Ilir Ramadani Dallduri, Avokat Agron Kajtazi and 764 others · 79 comments · 17 shares



Avokat Agron Kajtazi, Halim Krasniqi and 400 others · 25 comments · 19 shares



Opozita përjashton koalicionin me LV-në, pret dështimin e Kurtit që ta formojë qeverinë vetë

Liderët e partive opozitare të hënën kanë përjashtuar çdo mundësi bashkëpunimi për ndonjë koalicion me Lëvizjen Vetëvendosje e cila në zgjedhjet e 9 shkurtit ka dalë e para me vota me rreth 41.10 për qind, ndërkaq tri partitë opozitare bashkë kanë më shumë vota, rreth 47.48 për qind. Kandidati i PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza, në një konferencë për medie ka thënë se nuk do të hyjnë në koalicion me LV-në. Ai ka bërë me dije se do të punojnë për t'ua dhënë qytetarëve “qeverinë për të cilën kanë votuar shumica”

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

Prishtinë, 10 shkurt - Rezultatet preliminare për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit në Kosovë krijojnë paqartësi për përbërjen e re në Kuvend, por edhe të ekzekutivit të ri, vlerësojnë njohësit e çështjeve politike. Në bazë të rezultateve preliminare të publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), Lëvizja Vetëvendosje është partia që ka marrë më së shumti vota. Rezultati përfundimtar i votimeve do ta përcaktojë përbërjen e re të Kuvendit me 120 ulëse, ndërkaq deputetët më pas zgjedhin qeverinë e re. Sipas numërimit të mbi 97 për qind të vendvotimeve, LV-ja ka

fituar rreth 41.10 për qind apo 335 666 vota, pa arritur ta përsërisë suksesin e zgjedhjeve të vitit 2021, kur kishte marrë mbi 50 për qind të votave. Me 22.21 për qind apo 181 522 vota e dyta u rendit Partia Demokratike e Kosovës, ndërkaq e treta Lidhja Demokratike e Kosovës me 17.75 për qind apo 145 040 vota të fituara. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovë fitoi 7.47 për qind apo 61 065 vota. Lista Serbe ka fituar 4.07 për qind apo 33 275 vota, që nënkupton shumicën e votave të komunitetit serb në garë me pesë subjekte të tjera politike që garuan për votat e këtij komuniteti. Duke iu referuar rezultateve preliminare, lideri i Lëvizjes

Vetëvendosje, Albin Kurti, të dielën vonë ka deklaruar se “edhe sikur të bëhen bashkë PDK-ja dhe LDK-ja, ato nuk bëhen sa Vetëvendosja”. Ai ka paralajmëruar se do të vazhdojë të qeverisë me partitë Guxo dhe Alternativa, të cilat garuan brenda listës zgjedhore të Lëvizjes Vetëvendosje. “Jemi të parët e ky është konfirmim për një qeverisje të mirë, të mbarë dhe demokratike. Koalicioni ynë do ta formojë qeverisjen tonë 3... Ne jemi subjekti fitues që do ta formojë qeverinë e ardhshme”, tha Kurti. Partia Demokratike e Kosovës pozicionimin si forca e dytë politike pas zgjedhjeve e ka konsideruar rezultat të mirë për këtë parti. Kandidati i PDK-së për kryeministër,

Bedri Hamza, në një konferencë për medie ka thënë se nuk do të hyjnë në koalicion me LV-në, teksa ka shtuar se do të punojnë për t'ua dhënë qytetarëve “qeverinë për të cilën kanë votuar shumica”. “Sot është një ditë më ndryshe se dje, vullneti juaj u shpreh qartë dje. LV-ja ka humbur një numër të madh të votave, shumë qytetarë që e kanë votuar në të kaluarën, tashmë veç ia kanë kthyer shpinën. Ata erdhën kryesisht në PDK dhe në LDK. Kryeministri në detyrë i paraqiti këto zgjedhje si një referendum për vete dhe qeverinë e tij, por qëllimi nuk u arrit. Ai kërkoi 500 mijë vota, por nuk i mori, se nuk ia dhanë qytetarët. Sot shumica e qytetarëve që votuan nuk duan që e njëjta qeveri të vazhdojë. Qytetarët me vullnetin e tyre i kanë besuar opozitës, prandaj në këto zgjedhje i kanë fuqizuar partitë opozitare. Kjo më obligon mua dhe PDK-në, si partia më e madhe opozitare, që të sillem në mënyrë të përgjegjshme për ta respektuar vullnetin e shumicës shqiptare për ndryshim. Ne nuk do të përfshihemi në asnjë koalicion me LV-në. Kemi dallime të

mëdha. Ata duan pushtet absolut, s'kanë as program dhe gjatë fushatës ikën nga ballafaqimi edhe në studiot televizive. Ata i ofenduan kundërshtarët politikë, edhe qytetarët”, ka deklaruar Hamza, duke shtuar se e kanë detyrim dhe përgjegjësi t'ua japin qytetarëve qeverinë që ata duan dhe që e kanë votuar. Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, e ka përjashtuar mundësinë e një koalicioni me Lëvizjen Vetëvendosje të Albin Kurtit, duke thënë se pëlqen krijimin e një ekzekutivi nga partitë opozitare. Në një konferencë për medie të hënën, një ditë pas zgjedhjeve të rregullta parlamentare, kreu i AAK-së tha se nuk është i kënaqur me rezultatin e partisë së tij dhe të partnerëve të koalicionit parazgjedhor. “Unë mendoj se është në nderin tim që të ndihmoj një qeveri të opozitës assesi me LV-në, pra me zotin Kurti”, tha Haradinaj kur u pyet për mundësinë e koalicioneve paszgjedhore. Sipas Haradinajt, në zgjedhjet e 9 shkurtit partitë opozitare kanë fituar, pasi LV-ja në pushtet ka humbur votë. “Do të doja që Kosova të kishte një

rezultat më të mirë të opozitës, megjithatë e vërteta është që opozita ka fituar shumicën e votave krahasuar me partinë në pushtet, e cila edhe pas katër vjetëve në qeverisje nuk arriti t'i mbante votat që kishte pasur më 2021", tha kreu i AAK-së.

Ai tha se është i gatshëm të bashkëpunojë me subjektet opozitare shqiptare për të krijuar një shumicë pasi, sipas tij, kjo është e mundur. "Jemi të gatshëm për këtë, pa asnjë kusht", tha Haradinaj.

Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, edhe një herë i ka falënderuar votuesit që votuan këtë subjekt politik. "Ju faleminderit që mbështetët Lidhjen tonë! Të gjithë qytetarëve të Kosovës, ju faleminderit që nderuat demokracinë e atdheut tonë! Të gjithë veprimtarëve tanë, ju faleminderit që punuat me kaq vullnet e me kaq emocion në këto zgjedhje! Asgjë mangët! Punuam mbarë. Ecëm drejt. Ecëm si qytetarë me ëndrra të mëdha për këtë Republikë. Shpresoj t'ju kem prirë mbarë. Shpresoj t'ju kem përfaqësuar siç keni merituar gjithnjë! E shoh me plot krenari rrugëtimin e bërë deri më tani. Nuk dimë ndryshe, nuk duam ndryshe, nuk duhet ndryshe", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook".

Ai ka thënë se rritja e LDK-së i jep mundësi e qetësi organizimit më të mirë të brendshëm partiak dhe për këtë, thotë se do të qëndrojë gjithmonë krenar. "Kjo rritje është e pamjaftueshme për ndryshimin e Republikës në këtë fazë – dhe për këtë ndiej keqardhje. Pavarësisht të gjithave, do të ketë dritë! Në këtë fazë, vazhdojmë numërimin e votave të mbetura, sidomos ato në

mërgatë. Pas numërimit përfundimtar, LDK-ja do t'i ofrojë qëndrimet e veta politike", ka shkruar Abdixhiku.

Rezultati përfundimtar i votimeve do ta përcaktojë përbërjen e re të Kuvendit me 120 ulëse, ndërkaq deputetët më pas zgjedhin qeverinë e re. Komunitetet joshumicë kanë 20 ulëse të garantuara në Kuvendin e Kosovës. Prej tyre, dhjetë ulëse janë të garantuara për komunitetin serb.

"Kalkulimet" pas votave nga diaspora dhe me kusht

Rezultati preliminar aktual krijon situatë të paqartë dhe jopërfundimtare lidhur me atë se sa do të jetë numri i ulëseve në Kuvendin e Kosovës për secilin subjekt politik, si dhe kush do t'i qaset formimit të qeverisë së re, vlerësojnë nga Grupi Ballkanik për Politika në Prishtinë.

Drejtori i këtij grupi, Naim Rashiti, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se rezultatet aktuale mund të pësojnë ndryshime për cilindo subjekt garues, pas numërimit të votave nga jashtë Kosovës dhe të atyre me kusht. "[Lëvizja Vetëvendosje] ka [rreth] 42 për qind, që i bie 47 deputetë. Me votat e diasporës [votat nga jashtë] mund të kemi edhe dy ose tre deputetë. Nëse Vetëvendosja arrin në 49-50 [ulëse të Kuvendit] do të kemi kalkulime të tjera. Nëse subjektet e tjera e ulin dallimin me Lëvizjen Vetëvendosje, atëherë sërish do të kemi kalkulime të tjera", konsideron Rashiti.

KQZ-ja ka njoftuar më herët se 104 934 votues janë regjistruar për të votuar jashtë Kosovës

dhe 84 525 prej tyre zgjedhën që të votonin përmes postës. Përderisa numri i votuesve me postë mbetet të verifikohet, në disa përfaqësi diplomatike të Kosovës në botë kanë votuar 15 552 persona.

Numri i personave që kanë votuar me kusht ende nuk është dhënë nga KQZ-ja.

Edhe njohësi i çështjeve politike, Artan Muhaxhiri, vlerëson se rezultatet aktuale preliminare të subjekteve politike në zgjedhjet e 9 shkurtit krijojnë paqartësi lidhur me konfiguracionin e saktë të Kuvendit dhe qeverisë së ardhshme të vendit.

Bazuar në këto rezultate, sipas tij, Lëvizja Vetëvendosje, ndonëse është fituese e zgjedhjeve, nuk do të mund të qeverisë e vetme sikurse në mandatin e kaluar. "Nëse Lëvizja Vetëvendosje vendos që ta bëjë qeverinë vetëm me pakicat, atëherë kjo do të jetë një qeveri jashtëzakonisht jostabile, pasi që mezi do t'i arrijë 61 vota. Plus, mund të ketë probleme me Listën Serbe", thekson Muhaxhiri për Radion Evropa e Lirë dhe shton: "Nëse partitë opozitare mblidhen të gjitha, bashkohen dhe tentojnë të bëjnë qeverinë, edhe kjo qeveri do të jetë jostabile dhe me pak gjasa për jetëgjatësi politike".

Lëvizja Vetëvendosje gjatë fushatës zgjedhore ka përjashtuar mundësinë e një koalicioni paszgjedhor me partitë e deritashme opozitare. Një koalicion me Lëvizjen Vetëvendosje e kanë përjashtuar edhe dy partitë e tjera, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

Ndërkaq, Partia Demokratike e Kosovës, e cila, sipas rezultateve preliminare, është e dyta, nuk ka vënë "vija të

kuqe" për asnjë subjekt politik për koalicionet eventuale pas zgjedhjeve.

Muhaxhiri konsideron se rezultatet preliminare të zgjedhjeve i bëjnë të paqëndrueshme deklaratat e mëhershme të partive politike lidhur me koalicionet e mundshme pas zgjedhjeve. "Ky rezultat imponon kompromise. Nuk ka asnjë gjasë teorike që të ketë një qeveri të qëndrueshme pa bërë kompromise", shprehet Muhaxhiri dhe shton se në ditët në vijim, kur rezultatet përfundimtare do të shpallen nga KQZ-ja, "do të kemi pasqyrë më të qartë se cilat janë ato parti më të gatshme për të bërë kompromise".

A është e domosdoshme Lista Serbe për krijimin e qeverisë?

Tensionet e shpeshta në veri të Kosovës që nga viti 2022 e deri në zgjedhjet e sivjetme e kanë pozicionuar Listën Serbe si kundërshtarë të qeverisë aktuale të Albin Kurtit.

Artan Muhaxhiri thotë se mbetet të shihet nga rezultatet përfundimtare nëse Lista Serbe i ka fituar të dhjetë ulëset e garantuara për komunitetin serb në Kuvend. Por, edhe në rast se Lista Serbe i ka fituar jo të gjitha, por shumicën e mandateve të garantuara, atëherë ajo është përfaqësuesja më legjitime e komunitetit serb në Kosovë, e cila, sipas tij, nuk do të duhej të anashkalohej nga përfshirja në qeverisje nga kushdo që e formon ekzekutivin e ardhshëm. "Nëse bëhet një krahasim në mes të Lëvizjes Vetëvendosje dhe partive opozitare aktuale si partnere të Listës Serbe, atëherë


pakrahasueshëm më lehtë do ta bëjë Lista Serbe një koalicion me partitë opozitare", thekson Muhaxhiri. Por, ndryshe mendon Naim Rashiti. Ai nuk beson që subjektet politike shqiptare, cilado qoftë, do të llogarisin në Listën Serbe për formimin e qeverisë së re. "Ky precedent tashmë është krijuar edhe me situatat e fundit kur qeveria kishte emëruar ministra që nuk vinin nga Lista Serbe. Besoj se Lista Serbe do të mbetet jashtë ekuacionit të formimit të qeverisë", thekson Rashiti.

Ai shton se kushdo që do ta formojë qeverinë e ardhshme do të llogarisë që të krijojë partneritet me partitë e tjera serbe të Kosovës dhe jo me Listën Serbe.

Edhe Rashiti, por edhe Muhaxhiri, kritikuan Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për, siç thanë, "joseriozitet" në informimin e opinionit "përmes faqes së internetit". Derisa priteshin rezultatet preliminare nga pjesëmarrja në zgjedhje dhe numërimi i fletëvotimeve me rezultatet e partive politike, qasja në faqja e internetit të KQZ-së disa herë ishte e pamundur.

Në zgjedhjet e 9 shkurtit për përbërjen e re parlamentare garuan 28 subjekte politike dhe një kandidat i pavarur.

Të drejtë për të votuar në zgjedhjet e 9 shkurtit në Kosovë kishin 1 milion e 970 e 944 persona, prej të cilëve kanë marrë pjesë rreth 40 për qind. Pjesëmarrja në votim shënoi rënie në krahasim me zgjedhjet e vitit 2021, kur votuan mbi 48 për qind të personave me të drejtë vote. Për herë të parë në këto zgjedhje kanë votuar 125 mijë votues të rinj.



Jo fashizëm në demokraci: Rreshtimi i Kosovës me aleatët ndërkombëtarë - një domosdoshmëri për ta shmangur izolimin dhe konfliktin e ngrirë



Shkruan: Prof.
Dr. Fejzulla BERISHA

Rëndësia e rreshtimit strategjik për Kosovën

Në një botë gjithnjë e më të ndërlikuar dhe të ndërlidhur, vendet e vogla si Kosova përballen me sfida të mëdha në ruajtjen e sovranitetit dhe ndërtimin e një të ardhmeje të qëndrueshme. Rreshtimi me aleatët ndërkombëtarë, veçanërisht me ata që ndajnë vlera demokratike dhe interesa strategjike, është thelbësor për të shmangur izolimin dhe për të parandaluar përfshirjen në konflikte të ngrira. Historia ka treguar se vendet që nuk ndjekin një kurs të qartë politik të koordinuar me partnerët strategjikë rrezikojnë të izolojnë ekonomikisht dhe diplomatikisht, duke u bërë më të prekshme ndaj krizave të brendshme dhe kërcënimeve të jashtme. Në këtë kontekst, rasti i Kosovës kërkon një analizë të thelluar për të kuptuar pse rreshtimi me Perëndimin është jetik dhe çfarë rreziqesh mund të sjellë një devijim nga ky kurs. Në këtë analizë, do të

shqyrtojmë raste konkrete të shteteve dhe rajoneve që janë përballur me izolim ndërkombëtar ose konflikte të ngrira për shkak të politikave të tyre të jashtme, duke nxjerrë mësimet të rëndësishme për Kosovën.

RASTET E IZOLIMIT NDËRKOMBËTAR PËR SHKAK TË MOSRRESHTIMIT ME ALEATËT

1. Koreja e Veriut: Izolim Total dhe Pasoja Humanitare

Pas Luftës së Dytë Botërore, Gadishulli Korean u nda në dy shtete me ideologji të kundërta: Koreja e Veriut komuniste dhe Koreja e Jugut demokratike. Koreja e Veriut, nën udhëheqjen e Kim Il-sung dhe pasardhësve të tij, zgjodhi një politikë të vetëmjaftueshmërisë ekstreme dhe konfrontimi me Perëndimin. Pasojat: Izolim diplomatik dhe ekonomik: Refuzimi për t'u angazhuar me komunitetin ndërkombëtar dhe zhvillimi i programit bërthamor çuan në sanksione të ashpra ndërkombëtare, duke e izoluar vendin nga tregtia globale dhe ndihma ndërkombëtare. Kriza humanitare: Politikat e dështuara ekonomike dhe mungesa e ndihmës së jashtme shkaktuan uri masive, varfëri ekstreme dhe shkelje sistematike të të drejtave të njeriut. Mësimi për Kosovën: Një politikë e izolimit dhe konfrontimit me aleatët ndërkombëtarë mund të çojë

në pasoja të rënda ekonomike dhe humanitare. Rreshtimi me partnerët strategjikë është thelbësor për zhvillimin dhe stabilitetin.

2. Irani: Sanksione dhe tensione të vazhdueshme

Pas Revolucionit Islamik të vitit 1979, Irani adoptoi një politikë antiperëndimore dhe filloi zhvillimin e një programi bërthamor që shkaktoi shqetësime ndërkombëtare. Sanksione ekonomike: Programi bërthamor dhe mbështetja për grupet militante në Lindjen e Mesme çuan në sanksione të shumta nga SHBA, BE dhe OKB, duke dëmtuar rëndë ekonominë iraniane. Izolim diplomatik: Marrëdhëniet e tensionuara me vendet perëndimore dhe fqinjët rajonalë e lanë Iranin të izoluar në skenën ndërkombëtare. Mësimi për Kosovën: Mosrreshtimi me aleatët ndërkombëtarë dhe ndjekja e politikave që bien ndesh me konsensusin global mund të rezultojnë në izolim dhe sanksione që dëmtojnë zhvillimin kombëtar.

3. Venezuela: Kriza ekonomike dhe politike për shkak të politikave antiperëndimore

Nën udhëheqjen e Hugo Chavez dhe pasardhësit të tij Nicolás Maduro, Venezuela adoptoi politika populiste dhe

një qëndrim konfrontues ndaj SHBA-së dhe vendeve perëndimore.

Kolaps ekonomik: Nacionalizimi i industrive dhe menaxhimi i dobët ekonomik çuan në hiperinflacion, mungesa ushqimore dhe kolaps të shërbimeve publike. Izolim ndërkombëtar: Shkeljet e të drejtave të njeriut dhe manipulimi i zgjedhjeve rezultuan në sanksione dhe izolim diplomatik nga shumë vende.

Mësimi për Kosovën: Politikat që antagonizojnë aleatët ndërkombëtarë dhe shkelin parimet demokratike mund të çojnë në izolim dhe kolaps ekonomik.

RASTET E KONFLIKTEVE TË NGRIRA PËR SHKAK TË MOSRRESHTIMIT ME ALEATËT

1. Abkhazia dhe Osetia e Jugut: Konflikte të ngrira në Kaukaz

Pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, rajonet e Abkhasisë dhe Osetisë së Jugut shpallën pavarësinë nga Gjeorgjia, duke çuar në konflikte të armatosura. Njohje e Kufizuar: Vetëm disa vende, përfshirë Rusinë, njohin pavarësinë e këtyre rajoneve, duke i lënë ato në një status të paqartë ndërkombëtar. Konflikte të ngrira: Mungesa e një zgjidhjeje përfundimtare ka rezultuar në tensione të vazhdueshme dhe mungesë zhvillimi ekonomik. Mësimi për Kosovën: Mosrreshtimi me aleatët ndërkombëtarë dhe ndjekja e

politikave unilaterale mund të çojë në konflikte të ngrira dhe njohje të kufizuar ndërkombëtare.

2. Nagorno-Karabakh: Konflikti i Pambaruar midis Armenisë dhe Azerbajxhanit

Rajoni i Nagorno-Karabakut, me shumicë armene, shpalli pavarësinë nga Azerbajxhani pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, duke çuar në një luftë të përgjakshme. Status i paqartë: Pavarësia e Nagorno-Karabakut nuk është njohur ndërkombëtarisht, duke e lënë rajonin në një gjendje konflikti të ngrirë për dekada.

Tensionet e vazhdueshme: Përplasjet e herëpashershme dhe lufta e vitit 2020 tregojnë se konflikti mbetet i pazgjidhur. Mësimi për Kosovën: Kosova duhet të shmangë çdo politikë që do ta vendoste në një pozitë të ngjashme, duke ruajtur angazhimin e saj me partnerët strategjikë perëndimorë për të siguruar njohje të plotë dhe stabilitet afatgjatë.

Rruga e vetme është rreshtimi me aleatët

Kosova nuk mund të përballojë luksin e eksperimenteve gjeopolitike që rrezikojnë rreshtimin e saj perëndimor. E ardhmja e saj e qëndrueshme varet nga një politikë e mençur, që ruan marrëdhëniet me SHBA-në dhe aleatët evropianë, duke shmangur izolimin dhe konfliktet e ngrira që kanë dëmtuar vendet e tjera.

10 vjet nga nënshkrimi i marrëveshjes për drejtësi Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 10 SHKURT - Të hënën u mbushën dhjetë vjet që nga nënshkrimi i marrëveshjes për drejtësi në mes të Kosovës dhe Serbisë. Takimi ndërmjet kryeministrit asokohe të Kosovës, Isa Mustafa dhe atij të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, kishte përfunduar me nënshkrimin e marrëveshjes për drejtësi. Kjo, sipas ndërmjetësueses Federica Mogherini, ishte arritur rreth orës 02:00 pas mesnate. "Rezultat i mrekullueshëm në rifillimin e dialogut Beograd - Prishtinë! Faleminderit të djaja palëve", kishte shkruar Mogherini në ish-rrjetin social "Twitter", tash "X". Pas takimit, Mustafa kishte thënë se marrëveshja

mundëson funksionimin e sistemit unik të drejtësisë në Kosovë. I pyetur nëse janë diskutuar tema të tjera në dialog, Mustafa kishte thënë se nuk do të hapen tema të reja pa u shuar institucionet paralele në veri, me theks të veçantë "mbrojtja civile". Ndërsa Vuçiqi kishte thënë se me arritjen e marrëveshjes fiton Serbia dhe serbët e veriut, të cilët nuk do të mund të mbipërfaqësohen pasi Gjykata e Mitrovicës do të ketë 9 prokurorë shqiptarë dhe 9 serbë. Përfaqësuesja e BE-së, në anën tjetër, kishte bërë me dije se dy kryeministrit do të punojnë bashkë edhe rreth çështjes së migrimit ilegal të kosovarëve./kp/



Përkujtohen Mon Balaj dhe Arben Xheladini

PRISHTINË, 10 SHKURT - Kryeministri dhe lideri LV-së, Albin Kurti, bashkë me zëvendëskryeministrin Besnik Bislimi, kryetarin e Kuvendit, Glauk Konjufca, nënkryetaren e Kuvendit, Saranda Bogujevci, kryetarin e Podujevës, Shpejtim Bulliqi, bashkëkryetaren e Guxo, Donika Gërvalla, Avni Deharin, kryesuesen e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje!, Mimoza Kusari, sekretarin organizativ, Alim Rama, familjarë e miq të Monit dhe Arbenit, ministra,

anëtarë të kryesisë, deputetë dhe aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje!, bënë të hënën homazhe te varri i Mon Balajt në Podujevë dhe te varri i Arben Xheladinit në Prishtinë. Më pas ata vazhduan homazhet te pllaka përkujtimore e dëshmorëve Arben Xheladini dhe Mon Balaj, në sheshin "Nëna Terezë" në Prishtinë. "Më 10 shkurt 2007, pikërisht 18 vjet më parë, Arben Xheladini dhe Mon Balaj, bashkë me mijëra demonstrues të tjerë, marshuan paqësisht kundër

padrejtësive të Pakos së Ahtisaarit. Gjatë kësaj proteste, ata u qëlluan nga policia rumune e UNMIK-ut, e cila - siç vërtetohet në shumë raporte të organizatave për të drejtat e njeriut, përfshirë edhe Panelin Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut (2 mars 2015) - kishte përdorur forcë krejtësisht të panevojshme për t'i shpërndarë protestuesit. Sot, 18 vjet më vonë, ende mungon drejtësia për Arben Xheladinit dhe Mon Balajn.



Megjithatë, kërkesa jonë për drejtësi nuk do të ndalet kurrë, sepse ajo është e pandashme nga liria dhe vetëvendosja e

popullit të Kosovës. Nderim dhe lavdi jetës e veprës së Mon Balajt dhe Arben Xheladinit!", ka njoftuar LV-ja.

Oda Amerikane shpreh shqetësimin për sulmet verbale ndaj medieve dhe institucioneve të drejtësisë

PRISHTINË, 10 SHKURT - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë shpreh shqetësimin e saj të thellë lidhur me sulmet verbale të kryeministrit në detyrë ndaj gazetarëve dhe televizionit "Klan Kosova", një prej medieve më të mëdha në vend.

Në një reagim për medie thuhet se në një ditë kur qytetarët e Republikës së Kosovës demonstruan demokracinë në veprim, sulmet e tilla jo vetëm që përbëjnë një sulm ndaj lirisë së shprehjes, por përbëjnë një nxitje të drejtpërdrejtë të dhunës ndaj medias në fjalë, duke vënë në rrezik dhjetëra gazetarë dhe qindra punonjës të kësaj organizate. "Sulmet e vazhdueshme verbale ndaj bizneseve, disa medieve dhe

opinionistëve gjatë ditëve të fundit, si dhe ndaj prokurorëve dhe institucioneve të tjera të zbatimit të ligjit, cenojnë liritë themelore, për promovimin e të cilave shoqëria kosovare dhe partnerët ndërkombëtarë janë angazhuar dhe kanë investuar për vite me radhë. Për më tepër, sulmet ndaj institucioneve të pavarura të drejtësisë jo vetëm që shkelin parimin e ndarjes së pushteteve, por gjithashtu bien ndesh me parimin themelor të sundimit të ligjit, i cili ndalon ushtrimin arbitrar të pushtetit. Veprime të tilla dërgojnë sinjalin më negativ të mundshëm për qytetarët, bizneset vendore dhe investitorët e huaj, duke rritur pasigurinë juridike në Kosovë",

thuhet në reagim.

Ndër të tjera, bëhet me dije se Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë beson fuqishëm se liria e shprehjes duhet të respektohet në Kosovë, se pavarësia e të gjitha institucioneve duhet të garantohet dhe se ekzekutivi duhet të bashkëpunojë me të gjitha shtyllat e qeverisjes dhe institucionet joshkretërore të cilat luajnë një rol kyç në avancimin e demokracisë dhe promovimin e zhvillimit ekonomik në Kosovë. "Kosova duhet të mbetet një vend ku qytetarët e saj dëshirojnë të jetojnë dhe ku ndërmarrjet private mund të lulëzojnë pa frikën e veprimeve arbitrare", theksohet në reagimin e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.



Arrestohet ministri i Zhvillimit Rajonal, Fikrim Damka



Prishtinë, 10 shkurt - Ministri aktual i Zhvillimit Rajonal, Fikrim Damka, dhe një person tjetër janë arrestuar mbrëmje e së dielës, konfirmuan nga Policia e Kosovës dhe Prokuroria e Prizrenit. Rasti ka ndodhur rreth orës 18:00 të 9 shkurtit në Prizren dhe dy të dyshuarit për veprat penale "sulm" dhe "kanosje" janë arrestuar dhe intervistuar, konfirmoi për "Radion Evropa e Lirë" zëdhënësi i Policisë në Prizren, Shaqir Bytyqi, më pas ndaj tyre është shqiptuar masa e ndalimit prej 48 orësh.

Kryeprokurori i Prizrenit, Petrit Kryeziu, tha për "Radion Evropa e Lirë" se dy viktimat janë anëtarë të një partie turke, por rasti nuk ka të bëjë me zgjedhjet e 9 shkurtit, duke theksuar se nuk është cenuar integriteti i votës dhe votimit të zgjedhjeve parlamentare. "I kemi dy persona që janë ndaluar mbrëmë. Të dy janë për veprat penale 'sulm' dhe 'kanosje'. Janë dy viktimat të dëmtuar, që janë kanosur. Fillimisht është sulmuar një nga viktimat që është grua

dhe tjetri është burrë. Janë kanosur me jetë nga personat që janë të ndaluar", tha Kryeziu. Damka i përket Partisë Demokratike Turke të Kosovës, ndërkaq dy viktimat, sipas Kryeziut, ishin nga Partia Turke e Lëvizjes Novatore. Kosova më 9 shkurt mbajti zgjedhjet parlamentare dhe vëzhguesit, por edhe autoritetet, nuk raportuan për incidente serioze që do ta dëmtonin integritetin e votimeve.

Osmani me ftesë të presidentit Macron udhëton për në Paris

PRISHTINË, 10 SHKURT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, me ftesë të presidentit të Republikës Franceze, Emmanuel Macron, ka udhëtuar për në Paris. Gjatë qëndrimit në Francë presidentja Osmani do të marrë pjesë në Samitin për Inteligjencën Artificiale,

për krahu presidentit Macron, zëvendëspresidentit të Shteteve të Bashkuara, JD Vance, kryeministrit të Indisë, Narendra Modi, si dhe liderëve të tjerë botërorë. Në kuadër të vizitës, presidentja Osmani do të jetë e pranishme në darkën zyrtare në Pallatin Élysée, në pritjen zyrtare të organizuar

nga delegacioni amerikan, si dhe në seancën plenare të bashkëkryesuar nga presidenti Macron dhe kryeministri Modi. Gjithashtu, gjatë kësaj vizite do të organizohet një pritje nga zonja e parë e Francës, Brigitte Macron, ku është ftuar Zotëria i Parë, Prindon Sadriu.



FMN-ja, raporti: Shqipërisë i nevojiten reforma strukturore, pavarësisht pamjes optimiste makroekonomike

TIRANË, 10 SHKURT - Fondi Monetar Ndërkombëtar publikoi raportin për Shqipërinë, ku theksohet se gjatë vitit 2024 ekonomia shqiptare është një nga ekonomitë me rritjen më të shpejtë në Evropë bazuar te turizmi dhe politikat makroekonomike të kujdesshme, por ajo po përballet me vështirësi si plakja e shpejtë e popullsisë, emigrimi, prodhimitaria e ulët

dhe mangësitë e qeverisjes. Raporti, që erdhi në vijim të Misionit të FMN-së të mbajtur në muajin nëntor, thekson se, pavarësisht nga performanca e fortë, Prodhimi i Brendshëm Bruto (GDP) për frymë i Shqipërisë qëndron në rreth një të katërtën e nivelit të vendeve anëtare të BE-së. "Pavarësisht nga pamja optimiste makroekonomike, mbeten sfida të konsiderueshme strukturore.

GDP-ja për frymë qëndron në rreth një të katërtën e niveleve të ShBA-së dhe BE-së, ndërsa po ndodhin plakja e shpejtë dhe emigrimi. Nevojitet të ndërmerren reforma të gjera, në përmirësimin e qeverisjes, menaxhimin e financave publike, në rritjen e kapitalit njerëzor dhe prodhimitarisë për të nxitur një rritje më të qëndrueshme afatgjatë", theksohet në raportin e FMN-së për Shqipërinë.



Rritja e çmimeve, qytetarë të shumtë bojkotojnë supermarketet në Kosovë

PRISHTINË, 10 SHKURT - Qytetarë të shumtë i janë bashkuar iniciativës për bojkotimin e supermarketeve si rrjedhojë e rritjes së vazhdueshme të çmimeve. Ata e përkrahin këtë iniciativë, duke theksuar se shteti duhet të ndërmarrë masa për ta ndaluar këtë dukuri.

Iniciativa ka marrë mbështetje në rrjete sociale, ku është formuar një grup i qytetarëve që kanë bërë thirrje për bojkotim, i cili ka fituar mbështetje nga më shumë se 6 mijë qytetarë, ndërsa mbi 200 mijë të tjerë janë informuar për të.

Xhevat Kastrati, një nga themeluesit e iniciativës, tha të hënën se ka pasur raportime nga qytetarë të shumtë që kjo nismë po respektohet, gjithashtu përmendi se ka individë që nuk janë të informuar për bojkotin për shkak të zgjedhjeve.

Një iniciativë e tillë fillimisht u mor në disa vende të rajonit, Kroaci, Bosnjë-Hercegovinë, Mal të Zi dhe Maqedoni të Veriut.

Qytetarët në Kosovë ankohen për çmime të larta dhe manipulime me çmime në disa supermarketet.

Qytetari Nexhmedin Llapashtica i cili mbështet këtë nismë, thotë se bojkotet nuk

janë mjaftueshëm, dhe se duhet një reagim më i madh i popullit. "Jo bojkot, por duhet të ngritet populli dhe të çohen në 'luftë' qytetarët për këtë gjendje që po e shohim. Ka tri palë çmime të ndryshme në markete për të njëjtin artikull. Qytetarët duhet të vetëdijesohen. Patjetër se do ta përkrah këtë nismë dhe mendoj se shteti është fajtor, sepse nuk po i përcjell këto. Kam qenë në dijeni për nismën", thotë Llapashtica.

Se çmimet janë tejet të larta dhe kjo nismë duhet të mbështetet nga të gjithë thotë edhe qytetari Refik Ramaj. "Do ta zbatoj. Nismë e mirë dhe uroj të shkoj mirë. Do ta bojkotoj dhe nuk do të dal. Çmimet janë shumë të larta. Disa tepër të larta", thotë Ramaj.

Edhe qytetarja Sevdije Hoti thotë se kjo nismë është me vend pasi, siç thotë ajo, çmimet janë të larta. "Kam dëgjuar, ma kanë dhënë këtë informacion dhe nuk kam dalë. Kjo është nismë me vend. Çmimet janë të larta", thotë Hoti.

Mirëpo kjo nismë nuk do të përfundojë me sot pasi, sipas themeluesve të iniciativës, do të vazhdojë edhe në data të tjera. Themeluesi i iniciativës, Xhevat Kastrati, thotë se për datën



tjetër do të jenë më të organizuar për të njoftuar në masë më të madhe të qytetarëve. "Kemi raportime të shumta prej qytetarëve në grupin tonë në 'Facebook', disa thonë që ka njerëz, por disa të tjerë thonë se nuk janë duke blerë njerëzit në masë të madhe si zakonisht. Tash kemi mbi 6 mijë anëtarë në 'Facebook' dhe së paku këta do ta respektojnë iniciativën. Gjithashtu në instagram kemi arritur mbi 200 mijë njerëz përmes zotimeve tona dhe mijëra shpërndarje.

Po besoj që kemi arritur sadopak të ndikojmë tek ata që mos të blejnë sot. Në bazë të shikimeve, mbi 200 mijë qytetarë të Kosovës janë të informuar. Edhe zgjedhjet kanë ndikuar që mos me pas shumë përkrahje iniciativa, por do të vazhdojmë me iniciativa të tjera", thotë Kastrati.

Ditë më parë edhe kryetari i shoqatës "Konsumatori", Selatin Kaçaniku, e ka përkrahur iniciativën, duke theksuar se epoka e mashtrimeve dhe çmimeve

spekulative ka mbaruar. Ai për "KosovaPress" kishte thënë se çmimet në Kosovë janë të kurditura dhe duhet të jenë më të ulëta se në vendet e origjinës, duke shtuar se Kosova ka nevojë për përfaqësues tregtarë që do ta monitoronin ecurinë e eksporteve dhe importeve.

Nga rritja e vazhdueshme e çmimeve, qytetarë të disa vendeve të Ballkanit Perëndimor në fund të janarit u ftuan t'i bojkotojnë blerjet në disa dyqane të mëdha ushqimore.

Përmbillet projekti me GIZ-in "Bashkë për një ambient më të pastër"

PODUJEVË, 10 SHKURT - Komuna e Podujevës bashkë me GIZ-in gjerman kanë përmbyllur projektin "Bashkë për një ambient më të pastër". Me realizimin e këtij projekti, komuna me mbështetjen e GIZ-it dhe në bashkëpunim me kompanitë për menaxhimin e mbeturinave "Pastrimi" dhe "Natyra" kanë bërë hapa të rëndësishëm për ndarjen e mbeturinave në shkollë dhe institucione.

Rezultatet e këtij projekti janë: Në shkollën "Dr. Ibrahim Rugova" tashmë po ndahen mbeturinat e letrës dhe plastikës; 13 000 nxënës dhe

mësimdhënës nga shkollë të tjera janë trajnuar për ndarjen e mbeturinave përmes punëtorive dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese; Institucione të ndryshme publike janë pajisur me 374 kosha të mbeturinave (për letër, plastikë, të përzier, etj.), duke kontribuar në procesin e riciklimit; Numri i familjeve të regjistruara për grumbullimin e mbeturinave është rritur nga 13 440 në 19 454, falë bashkëpunimit me kompaninë "Pastrimi"; Vizitat studimore në kompani të menaxhimit të mbeturinave në Gjermani kanë ndihmuar



në përmirësimin e praktikave lokale.

Në përmbillje të këtij projekti, kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, falënderoi kryetaren e programit, Marianne Alker dhe të gjithë bashkëpunëtorët e projektit, pa të cilët do të ishte i pamundur ky rezultat. Institucionet publike në Podujevë kanë ndërtuar një shprehje e cila përafron me standardet e BE-së për ndarjen e mbeturinave, duke siguruar që letra dhe plastika të kontribuojnë në ekonominë për një të ardhme më të qëndrueshme.

Eksporti i Njeriut të Ri: Dhunë, vjedhje, nepotizëm, ryshfet, ligësi...



Nga: Dodë MËLYSHI

Në verën e vitit 1993, gjatë pushimeve verore, shkova dhe punova tre muaj si argat në Greqi. Ishte herë e parë dhe e fundit që e shkelja atë vend. Për hirë të së vërtetës, me një kushëri patëm provuar edhe verën pararendëse, atë të 1992-it, po na kapi ushtria kufitare greke në shoqërinë e të paktën njëqind shqiptarëve të tjerë të panjohur, sapo patëm kaluar kufirin, natën. Na ndaloi në mesnatë përmes krismash automatiku në ajër e, sensacioni i automatikut që të kërcëtoi të veshi me flakërimin e plumbave në qiell, nuk ishte asfare i bukur. Të nesërmen e asaj dite, jo pa peripeci, na kthyen në Korçë. Ndërsa, udhëtimi i '93-shit pati ma sukses. Qe i gjatë e, i lodhshëm, ndoshta ka zgjatë më shumë se 4-5 ditë e net. Udhëtonim më së shumti natën! Vetëm inkoshienca rinore e dëshpërimi masiv, që kishte pllakosur ndër ne, mund ta shtynte njeriun drejt aventurave të tilla!

Nuk e di sa kilometra kemi bërë në këmbë, ndoshta dyqind, ndoshta treqind, por di se në fund kam përfunduar në Selanik, me një ndërprerje të vetme rreth 20-30 kilometra rrugë me autobus. Në rrethinat e Selanikut, na ndihmoi një shok me u punësua për dy-tre muaj. Udhëtonim më së shumti natën, që të mos binim në sy. Qemë rreth dy-trembëdhjete vetë, të gjithë shokë, ose së paku të njohur. Më i madhi diku te njëzet vjet, më i riu ndoshta as gjashtëmbëdhjetë. Gjatë asaj aventure të parë emigrimi, janë së paku dy gjëra që do të mbaj mend e

s'do i harroj kurrë, e asnjëra s'ka lidhje me grekun, por me veten tonë.

E para i përket një nate, ndërsa kalonim diku nëpër rrethinat e Kosturit, në një plantacion të vogël mollësh të punuar e mirëmbajtur për mrekulli, me një sistem vaditës me tuba e sprucatore të vegjël, rrënjë në rrënjë, ne, ose më mirë disa nga ne, nuk i shpëtuam dot tundimit në udhëtim e sipër, me prish me këmbë ato tuba e atë sistem vaditës. Vandalizem falas e pa pikë përfitimi!

Grekët, gjatë udhëtimit, na jepnin bukë dhe ushqime dorë në zemër (ishim thjeshtë lypsa, me plot kuptim e fjalës, të veshur keq, të lodhur e të palarë, apo zhulsa dhe kromë, siç do thoshte dikush nga ne), e ne ua shpërblenim në këtë mënyrë!

E dyta ka të bëjë me natën e fundit të udhëtimit, diku mbas qytetit të Verias, përgjatë hekurudhës, kur një grup shqiptarësh të armatosur, madje deri në dhëmbë, kishin zënë pritë me plaçkit shqiptarët e tjerë që udhëtonin pa ditë se ku, në kërkim të fatit në atë tokë të huaj.

Aksioni i tyre do kishte pasur sukses, duke shfrytëzuar natyrisht edhe faktorin befasi e faktin që gati për të gjithë ne ishte hera e parë që shkonim në Greqi e s'njihnim as rrugët dhe as dinamikën e peripecitë e udhëtimit. Por, ç'e do se, askush ndër ne s'kishte para me vete! S'kishin ç'ka me plaçkit ata "patriotët" tanë "të dashur".

Në fillimvitet '90-të, pra, shqiptarët që kishin dalë në kërkim të fatit, si arrixhinjtë e vetëm si arrixhinjtë në Greqi (ndjesë që po përdor këtë

fjalë, por e bëj për lehtësi të kuptimit të ngjarjes), shpresonin që fati t'i ndihmonte me vandalizma e plaçkitje!

Sistemi i ri që ne e thërritem dhe e thërrasim mediokratikisht "demokraci", në vitet 1991-'93, nuk kishte kurrnjë mundësi fizike, pikërisht për arsye kohe, as për formuar as deformuar moralin e shoqërisë dhe rinisë shqiptare. E, pra, për momentin, asnjë përgjegjësi! Asnjë përgjegjësi të vetme!

Gjithçka ishim ne asokohe, qemë produkt i formimit dhe mendësisë që kishim marrë nga periudha e diktaturës. E pikërisht atëherë, shumë shqiptarë u bindën se jo vetëm Perëndimi i civilizuar, por edhe të "urryerit" fqinjët tanë, grekë serbë, apo turq paçin qenë, gjendeshin shumëfish në avantazh kundrejt nesh! Jo vetëm nga ekonomia, jo vetëm nga niveli i jetesës e zhvillimi, jo vetëm nga natyra, jo vetëm nga bukuria (herët e para "evropianet", na dukeshin tmerrësisht të pashëm e të bukur, tmerrësisht të mbajtur mirë), por çka është më e rëndësishme: nga kultura, nga mentaliteti e morali!

E, ishte pikërisht te formimi i "njeriut të ri" (produkt i komunizmit shqiptar), te formimi i shoqërisë që ai regjim i para viteve '90-të, e pati dështimin e tij më "spektakolar".

S'kishte si të ndodhte ndryshe. Në kohën e diktaturës, kur ishim fëmijë, kujtoj mirë se meritat e individit mateshin përgjithësisht me aftësinë që kishte ai me vjedh! Me vjedh sa më shumë: vidhej qysh fëmijë në shkolla (ikte lapsi, fletorja, çanta, topi, trikoja po

nuk ishte i vëmendshëm), vidhnin pastaj të rriturit: në kooperativa, në ferma bujqësore, në ndërmarrje shtetërore (se private nuk kishte), në udhëtim, në trena në autobus. Vidheshin deri çorapet, bluzat, çarçafët e brekët e varura gardhiqeve për t'u tharë pas larjes!

Vidhej gjithkund e gjithçka, e të gjithë ata që nuk vidhnin, nuk e bënin jo aq për moral dhe ndërgjegje, por vetëm nga frika. I varfri vidhte me dorën e tij, i pasuri, ose më saktë zyrtari, e kishte frigoriferin (një në njëmijë kishte frigorifer asokohe) plot, për meritat e ryshfeteve që merrnin nga nevojtarët. Pra, sistem i bazuar mbi dhunën, vjedhjen, nepotizmin, ryshfetin, ligësinë e tarafin!

Masat e rrepta ekstreme e primitive, që merrte shteti (kishte raste që për vjedhje të aplikohesh edhe dënimi me vdekje – me Kod Penal kjo ndodhte kur shuma e vjedhur kalonte mbi dy mijë lekë të reja) nuk bënin kurrnjë efekt! Treguesi më i mirë, se mënyra e fundit të formuar një shoqëri janë dhuna dhe dajaku...!

Në fakt shoqëria, s'kishte nevojë të formohej, mjaftonte të ruhej e perfeksionohej ai formim, që me mund e sakrificat të mëdha ishte konsoliduar ndër shekuj, por jo! U deformua gjithçka! U shkatërrua kuptimi i të qenurit: civil! U shemb edhe ankorimi i fundit ku shpëtonte morali civil e shoqëror: Feja! E, bashkë me të, edhe mësimet: "Nos i bëj tjetrit, çka s'dëshiron të të bëhet ty" dhe "mos vrit, mos vidh, mos rrej, mos dëshiro gjanë (pasurinë) e tjetrit" etj. Një sistem i dhunshëm dhe i padrejtë, që në bërthamë, nuk mund të bënte gjë tjetër, vetëm


se të gdhendte një shoqëri me moral e mendësi të dhunshme e, të padrejtë!

E, dami më i madh i atij sistemi nuk ishte ndoshta për gjatë ekzistencës së tij, por do jetë përgjatë 10-vjeçarëve që do ta pasojnë. Nga momenti që ka formuar një shoqëri të padenjë e të paafte për të jetuar në një botë të lirë e me norma e ligjësi demokratike.

Kështu pra, të gjithë ata që i delegojnë fajin sistemit demokratik, për dështimet që ka në Shqipëri e që përgjithësisht më së shumti janë nostalgjikë të diktaturës: ose nuk kanë njohje mirëfilli, ose arsyetojnë në ligësi e keqbesim! Një sistem që funksionon në Danimarkë dhe Suedi, mund dhe duhet të funksionojë edhe në Shqipëri. Tjetër pastaj se shqiptari është shqiptar e nuk është as danez e as suedez!

"Tash që kemi formue Italinë, duhet me formue italianët" – ka hy në histori kjo frazë e italianit të famshëm Massimo D'Azeglio, që para një shekulli e gjysmë, kur Italia u bashkua gjeografikisht e fizikisht. E përshtatur në kontekstin shqiptar të sotëm ose, të para 30 vitesh: "Demokracia erdhi, po shqiptari s'qe i gatshëm me bashkjetue me të"! "Duhet me formue shqiptarët me jetu të lirë, jo me pasë nostalgji për diktaturën" – do thoshte D'Azeglio!

Në fillimvitet '90-të, kush i kishte dy parë mend në krye, ka qenë i ndërgjegjshëm që rruga e Shqipërisë drejt demokratizimit, civilizimit e prosperitetit, do të ishte e gjatë dhe e mundimshme, pikërisht prej diktaturës traumatike që patëm kalue e deformimit e manipulimit gjenetik që pati marrë morali shoqëror



EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT
 PILKINGTON
 Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Thomasi largohet nga Trepça, transferohet në Izrael

KB Trepça ka njoftuar se fundori amerikan Larry Thomas është larguar nga skuadra, kurse karrierën do ta vazhdojë në Izrael. “Me marrëveshje

trepalëshe në mes të klubeve KB Trepça dhe A. S Ironi Ashkelon dhe vetë lojtarit ju informojmë që Larry Thomas karrierën do të vazhdojë në Izrael. Larryn e

falënderojmë për kontributin, profesionalizmin dhe përkushtimin e treguar për ngjyrat tona dhe i urojmë suksese në vazhdim të

karrierës”, thuhet në njoftimin e Trepçës. Thomas ka fituar Superkupën e Kosovës me Trepçën, ndërsa më herët ishte shpallur kampion edhe me

skuadrën e Pejës. Këtë sezon Thomasi ka luajtur me një mesatare prej 10 pikëve, 3 kërcimeve dhe 3 asistimeve për ndeshje.

Trepça - Drenica, sot përballja e parë e 1/8 së Kupës

PRISHTINË, 10 SHKURT - Sot (e martë) do të zhvillohet ndeshja e parë e 1/8 së finales së Kupës së Kosovës në futboll. Dy skuadrat e Ligës së Parë, Trepça dhe Drenica, përballen me synim për të avancuar tutje. Nesër (e mërkurë) zhvillohen pesë ndeshje të tjera, ku secila është më interesante se të tjetra. Përballja kryesore do të jetë në mes të Prishtinës dhe Suharekës, pa anashkaluar edhe ndeshjen tjetër që përballen Drita dhe Dukagjini. Vëllaznimi i Gjakovës e pret Gjilanin, ndërsa Llapi që po kalon nëpër një krizë rezultatesh në elitë, e pret Vushtrinë e



Ligës së Parë. Ndeshja e pestë është në mes të Dinamos dhe Malishevës. Të enjten zhvillohen dy ndeshje të tjera. Do të përballen Feronikeli 74 - Prishtina e Re dhe Ferizaj - Rilindja 1974.

ÇIFTET E 1/8 SË KUPËS

Të martën takohen:
 12:30 Trepça - Drenica

Të mërkurën takohen:
 12:30 Vëllaznimi - Gjlani
 12:30 Llapi - Vushtrria
 12:30 Prishtina - Suhareka 23
 12:30 Drita - Dukagjini
 12:30 Dinamo - Malisheva

Të enjten takohen:
 12:30 Feronikeli 74 - Prishtina e Re
 12:30 Ferizaj - Rilindja 1974

Të gjitha këto ndeshje zhvillohen nga ora 12:30.

Ferizaj merr tri pikë të mëdha në shtëpi ndaj Feronikelit '74

FERIZAJ, 10 SHKURT - Ferizaj ka shënuar fitore në shtëpi me rezultat 2-1 ndaj Feronikelit '74 në kuadër të javës së 19-të në Albi Mall Superligën e Kosovës. Ekipi i Arsim Abazit e ka nisur në mënyrë ta përkryer sezonin vjeshtor duke marrë tri pikë me rëndësi jetike para tifozëve të tyre. Iniciativa që patën “Ujqit” gjatë pjesës së parë bëri që ata të realizojnë dy herë për t'i siguruar pikët e plota. Ai që hapi këtë ndeshje ishte sulmuesi në formë Edon Sadriu, i cili realizoi për rezultatin 1-0 në minutën e 21-të. Vendësit nuk u ndalën me kaq dhe gjetën sërish rrjetën, kësaj radhe përmes Betim Haxhimusës, i cili në minutën e 40 shënoi për 2-0. Mysafirët ia dolën ta ngushtojnë epërsinë kur në



minutën e 80 gjetën golin përmes Arlind Malokut, por kjo nuk ishte e mjaftueshme për ta evituar humbjen. Me këtë fitore Ferizaj i ikën zonës së barazhit duke u pozicionuar në pozitën e

shtatë në tabelë me 23 pikë të grumbulluara. Feronikeli '74 në anën tjetër vazhdon të mbetet e fundit në tabelë me 10 pikë dhe tashmë numëron dy humbje radhazi pas asaj ndaj Dritës.

SHKURT

Liria realizon tri transferime

Skuadra e Lirisë nga Prizreni ka realizuar sot tri transferime shumë të rëndësishme për vijimin e kampionatit në Ligën e Parë. Fjala është për Alush Gavazaj, Bright Umeh dhe Engjëll Ajazaj. “Me kënaqësi ju njoftojmë se Alushi është zyrtarisht pjesë e klubit. Një lojtar me përvojë, i gatshëm ta japë maksimumin për ngjyrat bardh e zi”, thuhet në njoftimin e Lirisë. Transferimi tjetër i skuadrës që bënë gara në Ligën e Parë është mbrojtësi i krahut të djathtë, i ardhur nga Greenlock FC, Bright Umeh. “Me shpejtësinë, forcën dhe përkushtimin e tij, ai do të jetë një aset i rëndësishëm për ekipin tonë në rrugëtimin drejt sukseseve të reja”, ka shkruar FC Liria. Transferimi i tretë është Engjëll Ajazaj, i ardhur nga Ballkani.

Rrahmani: Nuk ishim konkretë, na mungoi pasimi i fundit

Amir Rrahmani, mbrojtësi i Napolit, foli për mikrofonat e La Domenica Sportiva në Rai 2 pas barazimit 1-1 kundër Udineses në javën e 24-t të Serisë A. Kapitani i Kosovës ka thënë se Napolit i mungoi konkretizimi në ndeshjen e fundit, prandaj nuk arriti të marrë më shumë se një pikë. “Mund të them që ne hyjmë në fushë në çdo ndeshje për të fituar, pastaj një pikë ose tri bëjnë diferencën. Sot ndodhi që nuk arritëm ta mbyllim ndeshjen, nuk ishim konkretë, na mungoi pasimi i fundit”, ka thënë Rrahmani. “Jo, po punojmë si gjithmonë. Nuk ka ndeshje të lehta për t'u fituar, gjithçka varet nga mënyra se si zhvillohet loja dhe si krijohet rastet. Ka shumë faktorë që ndikojnë në një fitore: qëndrimi dhe shpirti luftarak”, ka shtuar Rrahmani.

Emërllahu, afër transferimit në Rumani

Lindon Emërllahu i ka dhënë fund përvojës me Ballkanin. Futbollisti nga Kosova do të bëhet shumë shpejt me ekip të ri. Në fakt, përfaqësuesi pritet ta vazhdojë karrierën në Rumani, ku është nisur në orët e hershme të ditës së sotme. Më saktësisht, mesfushori pritet t'i bashkohet Clujit, ndërsa nga shitja e tij kampioni aktual i Kosovës mund t'i përfitojë 800 mijë euro deri në 1 milion euro. 22-vjeçari i ka zhvilluar 23 ndeshje me Ballkanin në këtë edicion, ndërsa i ka shënuar tre gola dhe e ka bërë një asistim. Vlera e tij në treg, sipas faqes së specializuar Transfermarkt, është 1 milion euro.

Daku në dyshim për ndeshjen ndaj Anglisë

Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Mirlind Daku, është lënduar dhe nuk dihet nëse do të jetë në dispozicion të elektorit Sylvinho për ndeshjet e

muajit të ardhshëm në kuadër të kualifikimeve për Botërorin 2026. Bëhet me dije se Daku ka ndrydhur kyçin e këmbës në miqësoren mes Rubin

Kazanit dhe ekipit nga Azerbajxhani, Neftçi Baku, të luajtur në Antalya të Turqisë. Daku është detyruar të largohet nga fusha pa përfunduar ndeshja, ndërsa

te Rubin Kazani kanë konfirmuar lëndimin e tij. Ditët në vazhdim do të mësohet shkalla e lëndimit të Dakut, i cili ka 9 gola e 5 asistime këtë sezon me

fanellën e Rubin Kazanit. Shqipëria luan me Anglinë dhe Andorrën më 21 dhe 24 mars në kuadër të kualifikimeve për Botërorin 2026.

Guardiola: Reali është kundërshtar i jashtëzakonshëm

MANCHESTER, 10 SHKURT - Pep Guardiola, trajneri i Manchester Cityt, doli në konferencë për shtyp në prag të ndeshjes kundër Real Madridit, e vlefshme për "play-off". "Nuk kemi bërë shumë mirë deri më

tani dhe meritojmë të jemi këtu ku jemi. Ne e pranojmë sfidën. Vitet e fundit kemi pasur një rivalitet të madh me Real Madridin". "Ata janë në krye të tabelës dhe po luftojnë kundër Athleticos dhe

Barcelonës. Ne do të duhet të luajmë dy ndeshje të mira për t'i mposhtur. Ne mund të luajmë mirë, por nuk jemi aq të qëndrueshëm sa kemi qenë. Nuk mund ta mohoj se kam besim te lojtarët që kanë

qenë kaq të mirë për një dekadë. Sulmuesit e Realit janë të jashtëzakonshëm. Ata kanë aftësinë për të bërë pasime të shkurtra dhe të gjata, kështu që ne duhet ta imponojmë lojën tonë", ka deklaruar Guardiola.



Schmeichel këshillon Eriksenin: Rikthehu në Ajax

MANCHESTER, 10 SHKURT - Ruben Amorim nuk po mbështetet shumë te Christian Eriksen. Kjo situatë mund ta bëjë danezin të mendojë për të ardhmen e tij. Siç shkruan "AS", Peter Schmeichel, legjenda daneze e Manchester Unitedit, i ka sugjeruar atij të ndryshojë ambient dhe të rikthehet aty ku gjithçka nisi: "Do të ishte një lëvizje e madhe për të të shkonte tek Ajaxi. Ai është mesfushor dhe në Premierë Ligë duhet dikush që vrapon për 90 minuta pa pushim". Sigurisht, edhe për shkak të moshës, performanca e ish-lojtarit të Interit ka rënë krahasuar me vitet e tij më të mira: "Edhe mënyra se si trajneri dëshiron të luajë nuk i përshtatet atij: rikuperim i shpejtë i topit dhe ritëm gjithmonë shumë i lartë. Nuk është në natyrën e tij dhe,



fatkeqësisht, nuk ka më atë energjinë që kishte kur ishte i ri. Megjithatë, teknikisht, edhe kur zotëron topin, ai mbetet një lojtar shumë i mirë. Mendoj se për Ajaxin do të ishte një blerje fantastike", ka deklaruar ai.

Ndërkohë, Manchester Unitedi ka mposhtur Leicesterin para tri ditësh në FA Cup me rezultatin 2-1, pasi

ishite në disavantazh 1-0 në "Old Trafford". Golat vendimtarë u shënuan nga Joshua Zirkzee, i ardhur nga Bologna në verë, dhe Maguire, i cili vazhdon të jetë i kritikuar nga tifozët e tij. Goli në minutat shtesë i ka qetësuar përkohësisht fishkëllimat në stadium, por në planin afatgjatë do të nevojitet më shumë.

Mick Schumacheri nuk heq dorë nga Formula 1: Pres surpriza në vitin 2026

GENOLIER, 10 SHKURT - Përvoja e Mick Schumacherit në motorsport këtë vit do të vijojë me makinën Alpine në kampionatin e WEC. Megjithatë, për herë të parë që nga viti 2021 djali i Michael Schumacherit do të jetë larg botës së Formula 1. I promovuar atë vit nga Haas, qëndrimi i 25-vjeçarit me ekipin amerikan përfundoi vitin e ardhshëm (2022), duke kaluar më pas te Mercedesi si pilot rezervë. Tani ai ka vendosur të jetë larg Formulës 1. Mundësitë për një rikthim në pistë këtë vit ishin të mëdha, por shpresat e Schumacherit u shkatërruan pas vendimeve të Alpine, vetë Mercedesit dhe Sauberit për t'u fokusuar te mjaft pilotë të rinj dhe fillestarë. Piloti gjerman aktualisht është gati për sezonin



e tij të dytë në WEC, pa hequr dorë nga F1. "Ëndrra ime është ëndrra ime. Kur jam në makinë jap 100%. Kjo do të thotë që kur jam në mjedisin WEC dhe gara, mendimet e mia janë 100% atje: në simulator, në takim, në çfarëdo tjetër", ka thënë Mick Schumacher.

Sezoni i ardhshëm do ta shohë gjermanin të angazhuar vetëm dhe ekskluzivisht në WEC, ndryshe nga angazhimi i tij i dyfishtë midis Kampionatit Botëror të Endurance dhe rolit të pilotit të tretë në F1: "Ishte padyshim një vit shumë i vështirë, patëm mjaft fundjavë njëra pas tjetrës, duke shkuar nga një garë në tjetrën". "Edhe nëse mund të thuash që piloti rezervë nuk bën shumë punë është e kundërta. Nga fundi i vitit unë isha relativisht i lodhur. Kyvit do të jetë më i qetë në këtë kuptim. Unë thjesht do të jem në gjendje të gjej kohë për të ngarë më shumë simulatorë dhe për të ndihmuar më shumë Alpine në zhvillimin e makinave, ndërkohë që fokusohem në anën sportive të garave", ka deklaruar Mick Schumacher.

SHKURT

Ramos: Në Meksikë kam ardhur për trofe

Mbrojtësi spanjoll Sergio Ramos ka thënë se në futbollin meksikan është transferuar në Rayados de Monterrey me idenë për të fituar tituj. "Unë nuk po vij në Meksikë për të bërë një shëtitje. Unë jam një person që nuk lodhet kurrë së fituari në futboll dhe nuk jetoj në të kaluarën. Po kërkoj trofe dhe mundësi të reja", ka thënë lojtari 38-vjeçar. Ramosi e ka pranuar se ka pasur oferta të shumta në tetë muajt e fundit dhe se vetëm ajo nga Monterrey e ka bindur sepse i ofron ekuilibrin që i nevojitet në këtë fazë të karrierës.

City, gati 170 milionë euro për dyshen e Leverkusenit

Manchester City raportohet se po synon të shpenzojë afër 170 milionë euro për të transferuar dy lojtarë nga Bayer Leverkuseni. "Caught Offside" raporton se City po monitoron nga afër dyshen Florian Wirtz dhe Jeremie Frimpong. Megjithatë, kjo nuk do të jetë e lehtë, pasi ata do të përballen me konkurrencë nga ekipe të tjera si Arsenali, Liverpooli, Real Madridi, Bayern Muncheni dhe Paris Saint-Germaini.

Kane: Jam i lumtur te Bayerni

Ditët e fundit bëri bujë prania e një klauzole lirimi në kontratën e Harry Kanes, që prej një viti e gjysmë luan me Bayern Munchenin në kampionatin gjerman. Sulmuesi anglez, që ka një kontratë deri në vitin 2027 me bavarezët, mund të largohet nga klubi gjerman në janar 2026, duke i paguar rreth 60 milionë euro. Në këtë aspekt, ish-lojtari i Tottenhamit ka preferuar të japë një deklaratë të thjeshtë para kamerave: "Jam i lumtur te Bayern Muncheni". Kane, 31-vjeçar, në 73 ndeshje zyrtare me bavarezët ka realizuar 72 gola, duke u konfirmuar një golashënues i vërtetë.

Monza bën ndryshime në shtabin teknik, rikthehet Nesta

Monza synon ta shpëtojë sezonin dhe pikërisht për këtë arsye, ka bërë ndryshime në bankinë. Klubi i Serisë A ka ndërprerë bashkëpunimin me trajnerin Salvatore Bocchetti dhe ka rikthyer në bankinë Alessandro Nestan. Alessandro Nesta merr sërish detyrën e trajnerit të ekipit të parë bardhekuq, shkruan klubi në rrjetet sociale. Monza, pas 24 ndeshjesh në kampionatin italian, mbyll klasifikimin me vetëm 13 pikë të grumbulluara.

Rashfordi pas debutimit me Aston Villën: Performancë e shkëlqyer ekipore

Marcus Rashford ka folur pas debutimit me Aston Villën në fitoren ndaj Tottenhamit. Aston Villa po mbulon pjesë të konsiderueshme të pagës

së Rashfordit, ndërsa e ka edhe opsionin për ta bërë të përhershëm transferimin e tij për 40 milionë euro. Ai e nisi nga banka rezervë në duelin

ndaj Tottenhamit në FA Cup, por u fut në lojë së bashku me Marco Asensio në pjesën e dytë. Me të përfunduar ndeshja ai shpërndau disa fotografi të

tij së bashku me tifozët duke e shoqëruar me m b i s h k r i m i n : "Faleminderit për mikpritjen e ngrohtë! Performancë e shkëlqyer

ekipore". Rashfordi do të synojë ta bëjë debutimin e plotë për klubin të shtunën, kur Villa do të jetë nikoqir i Ipswich Townit në Ligën Premierë.

 <p>KOMPANIA UJËSJETËSI RAJONAL SH.A. REGIONAL WATER COMPANY J.S.C. REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOOSNABDEVANJE D.D. PRISHTINA</p>	 <p>german cooperation DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT</p>	
<p>NOTIFICATION OF AVAILABILITY OF THE SCOPING DECISION REPORT FOR THE PROJECT CLIMATE APPROPRIATE URBAN DEVELOPMENT: SEWAGE PRISHTINA (INCL. SEWAGE I/II)</p> <p>As part of an agreement between the Republic of Kosovo and the Federal Republic of Germany, this project will contribute to environmentally friendly, hygienically safe, and sustainable wastewater and stormwater management in Greater Prishtina. This project is also in line with the national wastewater and resource protection strategy while fostering alignment with EU Standards, thereby contributing to sustainable urban development and climate adaptation.</p> <p>After disclosure of the Scoping Report at 13 November 2024, the Scoping Decision Report formalizing the scope and methodologies for preparing the international Environmental and Social Impact Assessment (ESIA) and related documents, being prepared as part of this project, is now available for acknowledgement on the website of the Regional Water Company Prishtina: www.kru-prishtina.com</p>	<p>NJOFIM PËR DISPONUESHMËRINË E DOKUMENTIT TË VENDIMIT PËR FUSHËVEPRIM PËR PROJEKTIN ZHVILLIM URBAN I PËRSHTATSHËM NDAJ KLIMËS: KANALIZIMI PRISHTINA (PËRFSHIRË KANALIZIMIN I/II)</p> <p>Në kuadër të Marrëveshjes mes Republikës së Kosovës dhe Republikës Federale të Gjermanisë, ky projekt do të kontribuojë në menaxhim të qëndrueshëm të ujërave të ndotura dhe ujërave të shiut, në formë miqësore ndaj mjedisit dhe higjienikisht të sigurt në Prishtinë dhe rrethinë. Ky projekt është gjithashtu në përputhje me strategjinë kombëtare për mbrojtjen e burimeve dhe trajtimin e ujërave të ndotura, duke përkrahur njëkohësisht përputhjen me standardet e BE-së dhe duke kontribuar në zhvillimin urban të qëndrueshëm dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.</p> <p>Pas publikimit të Raportit të Fushëveprimit më 13 nëntor 2024, Dokumenti i Vendimit për Fushëveprim, i cili formalizon fushëveprimin dhe metodologjitë për përgatitjen e Vlerësimit Ndërkombëtar të Ndikimit Mjedisor dhe Social (ESIA) dhe dokumenteve të lidhura, që po përgatiten si pjesë e këtij projekti, tani është i disponueshëm për njohje në faqen e internetit të Kompanisë Rajonale të Ujit Prishtina: www.kru-prishtina.com</p>	<p>OBAVEŠTENJE O DOSTUPNOSTI IZVEŠTAJA O ODLUCI O DELOKRUGU ZA PROJEKAT KLIMATSKI PRILAGOĐENI URBANI RAZVOJ: KANALIZACIJA PRISHTINA (UKLJ. KANALIZACIJA I/II)</p> <p>U okviru sporazuma između Republike Kosovo i Savezne Republike Nemačke, ovaj projekat će doprineti održivom upravljanju zagađenom vodom i kišnicom, na ekološki i higijenski bezbedan način u Prištini i njejoj okolini. Ovaj projekat je takođe u skladu sa nacionalnom strategijom za zaštitu resursa i tretman otpadnih voda, podržavajući usklađenost sa standardima EU i doprinoseći održivom urbanom razvoju i prilagođavanju klimatskim promenama.</p> <p>Nakon objavljivanja Izveštaja o određivanju delokruga 13. novembra 2024. godine, Izveštaj o odluci o delokrugu, koji formalizuje delokrug i metodologije za pripremu međunarodne Procene uticaja na životnu sredinu i društvo (ESIA) i pratećih dokumenata, koji se pripremaju kao deo ovog projekta, sada je dostupan za uvid na veb stranici Regionalnog vodovodnog preduzeća Priština: www.kru-prishtina.com</p>



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Imer Vitaku shpalle të pavlefshme diplomën e sh.m.m.t "Arkitekt Sinani" ish Boris Kidric.
- Arandjel Milanovic b.i p.p Aleksa shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. unik 810367856.
- Shefkije Kurti shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Osman Rama" Caber.
- Mirsad Selmani shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.t. "Arkitekt Sinani".
- Gani Delijaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV të sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Blerta Hajdari nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m. Muzikes "Prenk Jakova" Gjakovë.
- Gentiana Kurti nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Isen Kabashi shpall te pavlefshme diplomën Q K "11 Marsi" Prizren. Trumza Shala nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10. 11 të "Loyola Gymnasium" Prizren.
- Butrint Hasi B.I. nga Gjakova shpall të pavlefshme numrin e certifikatës së biznesit 812213480 të lëshuar nga ARBK.
- Vlora Kamberi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Zef Lush Marku" Brekoc KK Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Gani Delijaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Valon Beqiri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Arlinda Kalimashi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë. Albert Mehmeti nga Brovina kk Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl. I të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë paralele e ndarë në Ponoshec.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

